**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Komuna e Rahovecit**
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

**Zyra për Informim**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 1172 Më / Dt. 06.04.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

---

# Raporti i punës së zyrës për Informim Janar-Mars 2020

-Zyra për informim funksionon në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës, kjo zyrë punën e saj mbështet në statutin e komunës, rregulloren komunale për transparencë dhe planin komunal për transparencë për vitet 2019-2023.

-Lajmet, njoftimet dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë m zyrën e kryetarit, kryesuesit dhe drejtorive komunale, janë publikuar në uebfaqe dhe të njëjtat janë dërguar për publikim në portalet lokale gjithashtu edhe në ato nacionale, bashkëpunimi me media në përgjithësi është i mirë dhe se nuk kam pasur ndonjë vërejtje.

-Komuna e Rahovecit nga KDI, është renditur e para në mesin e 38 komunave të Republikës së Kosovës për transparencë, kjo është arritur falë punës që është bërë nga shumë zyrtar komunal, punë e mirë në rritjen e transparencës është duke u bërë në vazhdimësi.

-Nga kryetari i komunës me vendim jam caktuar Zyrtar përgjegjës për menaxhimin e platëformës së konsultimeve publike dhe koordinim për zbatimin e standardeve minimal të konsultimeve publike në komunën e Rahovecit, me të marrë vendimin në uebfaqe të komunës është krijuar një vegëlz për këtë platformë dhe që është aktive dhe qytetarët mund të hynë dhe të shoin dokumentet e komunës të cilat janë në konsultim-debat publik.

-Gjatë kësaj periudhe raportuese kam përgatitur planin për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunë.

-Pas problemeve të kohëpaskohshme që po ka në uebfaqe, kam përgatitur një dokument me vegëza të dokumenteve që publikohen në uebfaqe, kjo është bërë që të kamë dokumente që ti faktoj për ministritë apo edhe OJQ-të që e bëjnë monitorimin e komunës, pasi që ka pasur raste kur të gjitha dokumentet që janë publiku gjatë muajit shkurt janë fshi.

-Kam përgatitur regjistri për evidencën kërkesave të pranuara dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081.

-Gjatë kësaj periudhe raportuese ju njoftoj se janë publikuar 184 aktivitete-dokumente, detajet mund ti shihni në tabelën e mëposhtme.

| Muajt | Lajme | Njoftime | Ftesa | Thirrje | Vendime | Konkurse | Ankande | Debate | QDP | **Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për muaj** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.Janar | 24 | 10 | 0 | 1 | 19 | 1 | 0 | 1 | 2 | 58 |
| **2.Shkurt** | **17** | **5** | **0** | **0** | **21** | **6** | **0** | **1** | **0** | 50 |
| 3.Mars | 44 | 21 | 0 | 1 | 28 | 0 | 0 | 0 | 1 | 95 |

Haziz Krasniqi

Zyrtar për Informim